

VENDIM
Nr. 182, datë 26.2.2020

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, SI DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL
(ndryshuar me VKM nr. 707, datë 9.9.2020; me VKM nr. 189, datë 27.3.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 17, pika 1, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRITERET E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Përfutojnë pagesë të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe personat e përcaktuar në shkronjën “b”, të këtij ligji, deri në çastin e rivlerësimit nga komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

2. Individët, të cilët me vendim të komisionit përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfutojnë një ndihmës personal me pagesë.

3. Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, bëhet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) të nivelit të parë, të Shërbimit Social Shtetëror.

4. *Shfuqizuar.*

II. VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror funksionojnë komisionet e nivelit të parë dhe epror të vlerësimit të paratetraplegjisë dhe verbërisë.

1.1. Personi që vlerësohet për herë të parë për aftësi të kufizuar, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMCAP-së së nivelit të parë.

1.2. Rivlerësimi i personave me aftësi të kufizuar bëhet bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të personit me aftësi të kufizuar. Komisioni, në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë personin me aftësi të kufizuar për t'u paraqitur fizikisht në komision. Paraqitja në komision do të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data që do të realizohet vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në komision do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të KMCAP-së të nivelit të parë përballohen nga buxheti i Shërbimit Social Shtetëror.

5. Komisionet e nivelit të parë dhe epror KMCAP dhe KMPV marrin vendim për grupin e përfitimit, përfitimet dhe afatet e përfitimit për secilin grup, sipas anekseve nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Kundër vendimit të KMCAP-së të nivelit të parë personi mund të bëjë ankim në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (Komisioni Epror).

7. *Shfuqizuar.*

8. Kryetari dhe tre prej anëtarëve të komisionit janë mjekë me përvojë profesionale në fushën e ekspertizës. Në përbërje të çdo komisioni merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, një mjek, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror

dhe një jurist me përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar, përfaqësues i ministrisë që ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore çështjet e aftësisë së kufizuar. Anëtarët e komisionit duhet të kenë një figurë të pastër morale dhe të mos jenë të dënuar penalisht. Mandati i anëtarit të komisionit epror është pesëvjeçar dhe me të drejtë rrizjedhjeje.

9. Shfuqizuar.

10. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të komisioneve eprore përballohen nga buxheti i Shërbimit Social Shtetëror.

11. Masa e shpërblimit mujor të anëtarëve të komisioneve të nivelit të parë dhe komisioneve eprore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore.

12. Anëtarët e komisioneve nuk angazhohen në detyrat e përditshme të ushtrimit të profesionit të tyre dhe punojnë me kohë të plotë gjatë ditëve që janë të mbledhur në komision.

13. Personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Social Shtetëror.

14. Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

II/I Rregullat procedurale të vlerësimit nga KMCAP-ja

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), që bën vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, është organ mjekësor dhe ligjor që e ushtron aktivitetin e tij pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe përgjigjet para tij për aktivitetin që kryen.

2. Për të shqyrtuar dokumentacionin e vlerësimit/rivlerësimit dhe për të vlerësuar për herë të parë personat që kërkojnë të përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, KMCAP-të e nivelit të parë mbledhen jo më pak se 3 (tre) herë në muaj, ndërsa KMCAP-të eprore jo më pak se një herë në muaj. Për këtë qëllim, anëtarët e KMCAP-ve, për ditët që janë në komisione lirohen nga detyra e përditshme dhe punojnë pranë organeve të Shërbimit Social Shtetëror.

3. Anëtarët e KMCAP-ve njohin legjislacionin në fuqi, kriteret mjekësore për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe i zbatojnë ato drejt, saktë e me përgjegjësi profesionale.

4. Gjatë zhvillimit të seancës, anëtarët e KMCAP-ve studiojnë praktikën me dokumentacionin e plotësuar, vlerësojnë rastin, gjykojnë nëse plotësohen ose jo kushtet ligjore për përfitim, marrin të dhëna për ecurinë e sëmundjes dhe kohën e fillimit të trajtimit dhe në bazë të këtyre të dhënave marrin vendim mbi grupin e përfitimit:

- a) grupi i parë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për përkuqdesje;
- b) grupi i dytë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që nuk kanë nevojë për përkuqdesje;
- c) afatet e përfitimit për secilin grup;

ç) nevojën për përfitime të tjera sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Pas përfundimit të vlerësimit, dosjet e përfituesve të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person, dërgohen pranë drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për të kryer veprimet sipas përcaktimeve në pikën 9, të kreut IV, të këtij vendimi.

5. KMCAP-ja e nivelit të parë ka këto detyra:

a) cakton drejt dhe në përputhje me dokumentacionin shëndetësor dhe gjendjen shëndetësore të individëve që aplikojnë për herë të parë, si dhe në mbështetje të kriterëve mjekësore, përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar;

b) cakton datën e paraqitjes pranë KMCAP-së së aplikuesit për rastet që do të vlerësohen për herë të parë;

c) vlerëson dokumentacionin e drejtimit për në KMCAP "fletë drejtimin" i cili kur është lëshuar nga institucionet mjekësore të specializuara me shtretër (spitali) përmbajnë të gjitha rubrikat të plotësuara nga mjeku kurues sipas formatit, duke përfshirë dhe ID-n e personit dhe të nënshkruar nga mjeku kurues, shefi i pavionit apo klinikës, shefi i shërbimit dhe drejtuesit e institucionit. Pajisja ose jo me këtë dokument është vendosur në vizitën e përgjithshme ose në konferencën klinike të drejtuar nga shefi i klinikës ose shefi i shërbimit. Vendimi i marrë është i pasqyruar edhe në kartelën klinike të firmosur nga mjeku kurues, shefi i pavionit apo shefi i klinikës dhe në mungesë të tij shefi i shërbimit. Lëshohet nga komisionet mjekësore vetëm për rastet që nuk përbëjnë trajtim në institucione me shtretër të tilla si: sëmundje të syve, kirurgjikale, ortopedike, gjendje pas djegies dhe shëndetit mendor (raste që nuk përbëjnë trajtim në institucione me shtretër);

ç) vlerëson dokumentacionin e lëshuar nga specialistët, konsultat ose spitali, për rastet që rivlerësohen për aftësi

të kufizuar, i cili është plotësuar saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të personit me aftësi të kufizuar nga vlerësimi i fundit deri në rivlerësimin e radhës;

d) vlerëson analizat dhe ekzaminimet, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, të cilat janë të domosdoshme, për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të individit dhe që shoqërojnë fletën e drejtimit për në KMCAP;

dh) vlerëson dokumentacionin kur personi pretendon se ka një gjendje shëndetësore të rënduar, për të cilën nevojitet pajisja me “Fletëdrejtimi për në KMCAP”;

e) vlerëson shkakun e aftësisë së kufizuar nga sëmundje e përgjithshme, sëmundje të shëndetit mendor, përfitimet nga statusi paratetraplegjik, kohën e fillimit të pagesës, periudhën e përfitimit, si edhe afatin e rivlerësimit;

ë) shqyrton rastin brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi është marrë me procesverbal prej protokollit nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror dhe pasi ky i fundit ka kryer verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, për rastet që vlerësohen për herë të parë;

f) rivlerëson 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit që është vendosur në vendimin e fundit, dosjen që përmban dokumentacionin e plotë ekzistues, e cila shoqërohet me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore, të marrë në dorëzim me procesverbal nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror;

g) cakton pagesën për aftësinë e kufizuar, për periudhën e përfitimit, mbështetur në kriteret diagnostike të miratuara për çdo diagnozë;

gj) propozon drejtimit për riaftësimin profesional të personit me aftësi të kufizuar;

h) kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë, si edhe problematikën e aftësisë së kufizuar në qark.

6. Dosjet e personave me aftësi të kufizuar, që nuk përmbajnë dokumentacionin për rivlerësim në KMCAP në datën e rivlerësimit, ruajnë të drejtën e rishqyrtimit gjatë periudhës tremujore në vazhdim. Kur dokumentacioni paraqitet brenda kësaj periudhe, e drejta e përfitimit ruhet edhe për periudhën e prapambetur.

7. Kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet në KMCAP edhe gjatë kësaj periudhe, KMCAP-ja e konsideron dosjen të mbyllur dhe praktika dubet të nisë si procedurë vlerësimi për herë të parë me detyrimin e paraqitjes në komision të individit.

8. Procesi i vlerësimit/ rivlerësimit për përfitim të pagesës së aftësisë së kufizuar bëhet në zbatim të kriterëve mjekësorë dhe diagnostikë, periudhës së riaftësimi, për të cilën afatet e rivlerësimit shtrihen në kohë sipas kriterëve mjekësorë.

9. KMCAP-ja eprorë ka këto detyra:

a) shqyrton dhe zgjidh kërkesat e personave me aftësi të kufizuar, që ankimojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë, si edhe shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

b) studion praktikën e dërguara nga Kontrolli i Shërbimit Social Shtetëror, merr masa për plotësimin e tyre, thërret dhe viziton rastin në mbledhjen e radhës dhe në varësi të problematikave të konstatuara dhe gjendjes shëndetësore merr vendim për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;

c) sipas natyrës dhe rëndësisë së shkëlqeve urdhëron KMCAP-në e nivelit të parë që të rivlerësojë përfituesit dhe të rregullojë vendimet, ku caktimi i pagesës së aftësisë së kufizuar ka qenë i kundërligjshëm ose organizon vetë një seancë të veçantë për rikontrollin e tyre. Në këto raste, KMCAP-ja, për çdo individ që do të rivlerësojë, merr vendim të ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;

ç) kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë e sëmundshmërisë dhe cakton drejtimit e rrugët për përmirësimin e treguesve.

10. Vendimi i KMCAP-së së nivelit të parë dhe KMCAP-së eprorë është dokumenti bazë juridik-mjekësor-administrativ që njih të drejtën për përfitime të aftësisë së kufizuar. Ai plotësohet saktë, qartë, me përgjegjësi, sipas kërkesave të formatit, me shkrim të lexueshëm, pa korrigjime, vërtetohet me emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të KMCAP-së, nënshkrimin e tyre, si dhe vuloset me vulën e komisionit. Vendimi ka fuqi ligjore ekzekutive kur është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të komisionit.

11. Në rastet kur ndërmjet anëtarëve të komisionit ka mendime të ndryshme, vendimi merret me divergjencë dhe anëtari që nuk është dakord me të tjerët argumenton vendimin me arsyet e divergjencës. Në këto raste, vendimi nuk ka fuqi ligjore ekzekutive dhe së bashku me dosjen dërgohet zyrtarisht në KMCAP-në eprorë të

specializuar.

12. Kur anëtarët e KMCAP-së eprore të specializuar kanë mendime të kundërta, vendimi merr formën e prerë me shumicë votash.

13. Vendimi i KMCAP-së eprore të specializuar nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Në ato raste kur KMCAP-ja e nivelit të parë gjykon se kërkuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të KMCAP-së eprore të specializuar.

14. Vendimi, në çdo rast, plotësohet gjatë mbledhjes. Krabas plotësimi të vendimit, plotësohet edhe vërtetimi, i cili përmban shkurtimisht të dhënat kryesore të vendimit.

III. MASA E PËRFITIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar, e përcaktuar sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, është 10 653 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar dhe pagesa e ndihmësit personal indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

2. Personat me aftësi të kufizuar, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar, dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin kursin e kualifikimit/vitin shkollor vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/viti shkollor, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/vitit shkollor.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

4. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin, njëkohësisht, arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërën nga pagesat.

5. Personat e përcaktuar sipas pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, me plotësimin e moshës dhe të kushteve për përfitim pensioni, sipas përcaktimeve në legjisllacionin në fuqi për sigurimet shoqërore, ndërpresin pagesat që përfitojnë sipas këtij vendimi.

6. Pagesa e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar, sipas shkronjës “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, është në masën 11 190 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj. Kjo pagesë indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

7. Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

8. Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindjeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.

9. *Shfuqizuar.*

10. Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes, për efekt

të llogaritjes së ndihmës ekonomike.

11. Paguesa për personat që përfitojnë nga ky vendim dhe e ndihmësit personal bëhet një herë në muaj, nëpërmjet shërbimit bankar ose Postës Shqiptare, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

12. Personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të kreut I, të cilët vlerësohen për herë të parë në KMCAP, u lind e drejta e përfitimit të pagesës në muajin pasardhës, nga data e marrjes së vendimit nga ky komision.

113 Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar ndërpritet:

- a) kur personi refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara;
- b) kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e organizimit, të të drejtave, detyrave dhe funksionimit të komisioneve të vlerësimit;
- c) kur personi nuk paraqitet në komisionin epror dy herë radhazi dhe refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara/mjekimin e rekomanduar/ marrjen e shërbimit të rekomanduar;
- ç) kur vërtetohet që personi nuk është rezident në Shqipëri;
- d) kur personi ka qëndruar për më shumë se tre muaj jashtë Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për arsye shëndetësore;
- dh) për personat e përcaktuar në nenin 11, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR VLERËSIM DHE PËRFTITIM PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP. *Për rivlerësim shqyrtohet dokumentacioni mjekësor i rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit.* Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.

2. Për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët me vendim të komisionit mjekësor është përcaktuar se kanë nevojë për përkujdesje, plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacioni për ndihmësin personal, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë, paraqesin çdo fillim të vitit të ri shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimin, të nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të lartë, ku të shënohen emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor, vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;

b) Kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së lartë, si dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.

c) *Dokumentacioni për ndjekjen e arsimit të mesëm të lartë merret nëpërmjet ndërveprimit mes Regjistrat Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).*

4. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik, paraqesin kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

5. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror ose rajonal ka të drejtë të verifikojë, me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit, vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.

6. *Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të Shërbimit Social Shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku i Shërbimit Social Shtetëror*

verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të krenut I, të këtij vendimi.

7. Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton personin 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit.

8. Personat, të cilëve u ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimi të re.

9. Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat aplikues, hedhin në arkivin elektronik, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e vlerësimit/rivlerësimit, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative, të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.

10. Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shpeshë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat.

11. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar nën juridiksionin e saj dhe mundëson ekzekutimin e pagesave brenda afateve ligjore.

12. *Dosja me dokumentacionin e plotë të personit me aftësi të kufizuara sistemohet në praktikën e tij të veçantë, mbahet dhe ruhet në njësinë administrative/bashkinë ku ka vendbanimin individuali.*

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT NË KOMISIONIN EPROR

1. Kundër vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë personi mund të bëjë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në komisionin epror. Procedura e ankimit kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ankimi në komisionin epror bëhet me shkrim dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror;

b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror dërgon në Shërbimin Social Shtetëror dosjen e ankimuesit, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

c) Shërbimi Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së eprorë dhe ankimuesit 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së komisionit epror.

2. *Mjeku pranë Shërbimit Social Shtetëror studion dokumentacionin e dosjes, procedurat e zbatuara në komisionin e nivelit të parë, dokumentacionin e vlerësuar nga ky komision dhe pretendimet e parashtruara nga ankimuesi.*

3. Seancat e mbledhjes së komisionit janë të përmuajshme dhe zhvillohen brenda një muaji, nga data e paraqitjes së dokumenteve në Shërbimin Social Shtetëror. Seanca zhvillohet në ditët e caktuara nga komisioni epror, i cili tërhiqet për të marrë vendimin pa praninë e personit. Komisioni epror mbledhet jo më pak se dy herë në muaj dhe kur janë mbledhur jo më pak se 20 dosje.

4. Vendimet e komisionit epror merren me shumicë të thjeshtë votash. Mbledhja mund të zhvillohet edhe në mungesë të njërit prej anëtarëve, *por asnjëherë në mungesë të kryetarit/ zëvendëskryetarit.* Në rastet kur ka barazi votash, në fund vendos vota e kryetarit të komisionit.

5. Anëtarët e komisionit epror kanë të drejtë të argumentojnë votën e tyre pro ose kundër. Vendimi i komisionit epror plotësohet sipas formatit nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Vendimi i komisionit epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor.

7. Nëse ankimuesit nuk paraqiten para komisionit 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, komisioni epror merr vendim “pa aftësi të kufizuar”, dhe dosja i kthehet drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten para komisionit për herë të parë.

8. Komisioni epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore, për të cilën pretendohet aftësi e kufizuar.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit për përfitim si kategori e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me përcaktimet në këtë vendim, individët, të cilët janë kategori përfituese e pagesave të aftësisë së kufizuar sipas vlerësimit biopsikosocial, të përcaktuar në vendimin nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

2. Vendimi nr. 618, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore e sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Affësisë për Punë, i mbledhur më datë ____/____/_____, pasi shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e aplikuesit _____, konstatoi se:

Kuadri klinik sipas dokumentacionit mjekësor: _____

Përshkrimi i analizave dhe i ekzaminimeve bazë: _____

Diagnoza: _____

Kodi i sëmundjes: _____

Mbështetur në dokumentat, diagnozën, ekzaminimet, si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____, _____ përfitues i statusit para-tetraplegjisë, grupi _____, prej datës ____/____/_____ deri më ____/____/_____.

Sipas ligjit nr. 8626 datë 22/06/2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", ligjit 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Z/Znj _____, ka nevojë për paketë të veçantë higjeno-sanitare, sipas VKM nr. 78 datë 07/02/2007, të ndryshuar.

Afati i rikontrollit në KMCAP:

Dokumentacioni mjekësor për rikomisionim: _____

Shënim: _____

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____



VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV), i mbledhur më datë ____/____/_____, pasi shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e aplikuesit _____, konstatoi se:

Kuadri klinik sipas dokumentacionit mjekësor: _____

Përshkrimi i analizave dhe i ekzaminimeve bazë: _____

Diagnoza: _____

Kodi i sëmundjes: _____.

Mbështetur në diagnozën,, mprehtësinë e pamjes (visus) të përshkruara në dokumentacion :

VENDOSI:

Z./Znj. _____, e ka mprehtësinë e pamjes në masën _____

dhe _____ përfiton "statusin e të verbrit", grupi i _____, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar, prej datës ____/____/_____ deri më ____/____/_____.

Këshilla mjekësore për riaftësim _____

Afati i rikontrollit në KMPV: _____
Z./Znj. _____ ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Dokumentacioni mjekësor për rikomisionim _____

Shënim: _____

Anëtar Anëtar Anëtar Anëtar
() () () ()

Anëtar
(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT
(_____)

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
KMCAE EPROR PËR PARAPLEGJI TETRAPLEGJI

VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, Epror, i mbledhur më datë _____, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e Z./Znj. _____, që me vendim nr. _____, datë _____ KMCAE të nivelit të parë _____, është deklaruar _____, pasi vuan nga sëmundja:

KMCAE Epror, pasi e vizitoi të sëmurën/ të sëmurin, kostatoi se vuan nga sëmundja:

Mbështetur në dokumentat, diagnozën si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____, _____ përfitues i statusit para-tetraplegjisë, grupi _____, prej datës ____/____/____ deri më ____/____/____.

Sipas ligjit nr. 8626 datë 22/06/2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", ligjit 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Z/Znj _____, ka nevojë për paketë të veçantë higjeno-sanitare, sipas VKM nr. 78 datë 07/02/2007, të ndryshuar.

Rikontroll në KMCAE EPROR: _____ në muajin _____

Dokumentacioni mjekësor për rikomisionim: _____

Shënim: _____

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

(_____) (_____) (_____) (_____)

Anëtar

(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)

Aneks nr.3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËR OR
KMPV EPROR PËR VERBËRI

VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë, Epror, i mbledhur më datë _____, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e Z./Znj. _____, që me vendim nr. _____, datë _____ KMPV të nivelit të parë _____, është deklaruar _____, pasi vuan nga sëmundja:

KMPV Epror, pasi e vizitoi të sëmurën/ të sëmurin, konstatoi se vuan nga sëmundja:

Mbështetur në dokumentat, diagnozën si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë se z.znj _____, përfiton statusin e të verbërit, grupi _____ prej datës ____/____/____ deri më datën ____/____/____ sipas ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim.

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Rikontroll në KMCAP EPROR: _____ në muajin _____
Dokumentacioni i kërkuar për rikomisionim: _____

Shënim: _____

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

(_____) (_____) (_____) (_____)

Anëtar

(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)

Aneks nr.4